

Standardi puro Serb me titull ***“Draft-ligj mbi metrologjinë”***.

Ky standard 24 faqësh, rregullon aspekte të metrologjisë, njësive matëse të njohura me ligj dhe standardeve të kësaj fushe në Republikën Serbe. Gjithashtu rregullon aspekte të aplikueshmërisë së këtyre rregullave teknike në treg, përdorimin e instrumentave matëse, vlerësimin e përputhshmërisë së instrumentave matëse me kërkesat e përcaktuara, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me metrologjinë.

Në objektiv është harmonizimi i kuadrit ligjor me dispozitat e Ligjit mbi Mbikëqyrjen e Inspektimit, si dhe harmonizimi me parashikimet e Ligjit mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative .

Afati i fundit për marrjen e komenteve është ***19.07.2019***.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre. Komentet potenciale adresohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila me ligj është pika e kontaktit për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi standardet dhe rregullat teknike.